



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 685/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-33285-08-09-2019, me objekt: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti Jugor nga Fushat e Sportit deri tek Tuneli”, me fond limit 458.286.818,65 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Gjithashtu kërkohet shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me operatorin ekonomik të renditur i pari në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k.  
Rruga “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap.3, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.08.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-33285-08-09-2019, me objekt: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti Jugor nga Fushat e Sportit deri tek Tuneli”, me fond limit 458.286.818,65 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 12.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |   |                                |
|---|--------------------------------|
| 1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k.<br>& “Xhengo” sh.p.k. | 357.403.750 lekë, skualifikuar |
| 2. “Fusha” sh.p.k.  | 385.173.305 lekë, kualifikuar  |
| 3. “Salillari” sh.p.k.  | 413.043.173 lekë, kualifikuar  |
| 4. “Gjikuria” sh.p.k.   | 425.919.604 lekë, skualifikuar |
| 5. “Be – Is” sh.p.k.  | 426.718.645 lekë, skualifikuar |
| 6. “Gener – 2” sh.p.k.  | 435.805.674 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 24.09.2019, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori në bashkim “Curri” sh.p.k, nuk përmbush kriterin në pikën 2.3.1 “Përvojë të suksesshme për kontrata të ngjashme”. Punët e prezantura nga operatori ekonomi “Curri” sh.p.k, të cilat mund të konsiderohen të ngjashme nuk përmbushin vlerën e cila kërkohet nga ky operator ekonomik si pjesëtar me pjesëmarrjen më të madhe në JV. Kontrata “Rikonstruksioni i Rrugës Cërrik - Belsh -Dragot” me vlerë 318,219,525 lekë pa TVSH, nuk mund të konsiderohet kontratë e ngjashme, pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji. Kontrata “Rikonstruksioni i Shëtitorës së Vlorës” do të zhvillohet në një ambient kompleks urban, për më tepër, natyra e punëve të parashikuara në këtë kontratë, përfshin metodologji dhe teknologji të lidhura me rikualifikimin urban. Gjithashtu në këtë kontratë nuk janë përfshirë punime asfalti por vetëm shtrime pllakash, ndriçim dhe mobilim urban, punime të cilat nuk janë prezent në kontratën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k “Rikonstruksioni i Rrugës Cerrik - Belsh - Dragot”.*
- *Operatori në bashkim “Xhengo” sh.p.k, nuk përmbush kriterin e licencave në pikën 2.3.4, nuk ka paraqitur licencën NP-8C për punime në det, pasi ka marrë përsipër punime betoni për shkallaret në det.*

II.3.1. Në datën 27.09.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

*Shoqëria “Curri” sh.p.k. është ofertuese në procedurën e prokurimit të zhvilluar na Fondi Shqiptar i Zhvillimit në datën 05.07.2019 me objekt “Vazhdimi i shëtitorës së Vlorës – Segmenti Jugor nga Fushat e Sportit deri tek Tuneli”, REF 33285-08-09-2019, me fond limit 458.286.818,65 lekë pa tvsh.*

Nëpërmjet mesazhit elektronik të datës 24.09.2019 në sistemin e prokurimit elektronik të APP jemi njohur me kuotimin e bërë nga KVO dhe vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit kontraktor për për klasifikimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi dhe skualifikimin e ofertës tonë. Skualifikimin e ofertës tonë e konsideruam të padrejtë dhe të pambështetur në ligj dhe në dokumentat e ngarkuara në këtë procedurë prokurimi.

Vlerësimet për tenderin: “Vazhdimi i shëtitorës së Vlorës – Segmenti Jugor nga Fushat e Sportit deri tek Tuneli”, REF 33285-08-09-2019, me fond limit 458.286.818,65 lekë pa tvsh.

Operatorët ekonomikë vlerat e ofertuara

Operatorët ekonomikë	vlerat e ofertuara	refuzuar
1. Curri	357.403.750	po
2. Fusha	385.173.305	jo
3. Salillari	413.043.173	jo
4. Gjiguria	425.919.604	po
5. Be – Is	426.718.645	po
6. Gener – 2	435.805.674	po

Arsyet e refuzimit të ofertës nga KVO

- Operatori në bashkim “Curri” sh.p.k, nuk përmbush kriterin në pikën 2.3.1 “Përvojë të suksesshme për kontrata të ngjashme”. Punët e prezantura nga operatori ekonomi “Curri” sh.p.k, të cilat mund të konsiderohen të ngjashme nuk përmbushin vlerën e cila kërkohet nga ky operator ekonomik si pjesëtar me pjesëmarrjen më të madhe në JV. Kontrata “Rikonstruksioni i Rrugës Cërrik - Belsh - Dragot” me vlerë 318,219,525 lekë pa TVSH, nuk mund të konsiderohet kontratë e ngjashme, pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji. Kontrata “Rikonstruksioni i Shëtitorës së Vlorës” do të zhvillohet në një ambjent kompleks urban, për më tepër, natyra e punëve të parashikuara në këtë kontratë, përfshin metodologji dhe teknologji të lidhura me rikualifikimin urban. Gjithashtu në këtë kontratë nuk janë përfshirë punime asfalti por vetëm shtrime pllakash, ndriçim dhe mobilim urban, punime të cilat nuk janë prezent në kontratën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k “Rikonstruksioni i Rrugës Cërrik - Belsh - Dragot”.

1. Sqarime në lidhje me arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor:

Referuar kërkesa për kualifikimi sipas DST:

2.3. Për kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga autoriteti kontraktor si më poshtë:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloragitur të kontratës që prokurohet (229.143.409,33 lekë pa tvsh) të realizuar nga operatorë ekonomikë gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet..

plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Mbështetur në këto kërkesa, ne kemi ngarkuar në këtë procedurë prokurimi këto objekte të ngjashme:

Nr.	OBJEKTI I KONTRATËS	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	VLERA PA TVSH
1.	Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rr. Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Rr. Anesti Lubonja, si dhe tek ish Pista e Aviacionit, Njësia Bashkiake nr. 7	09.05.2016	27.10.2016	79.785.725
2.	Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik Belsh – Dragot – Kuçovë-Urë Vajgurore (Segmenti degëzim Grekan – Dragot)	29.05.2017	22.12.2017	318.219.526
3.	Ndërtimi i urës së Lushës mbi Lumin Drin, Komuna Arras	09.07.2015	20.12.2016	59.706.577
4.	Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman	18.10.2017	20.06.2018	266.141.390
5.	Sistemim asfaltim i rrugës së unazës “Poliklinikë – 7 pallatet”, Vlorë	06.07.2016	05.07.2017	346.751.747
6.	Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku, sheshi i Poliklinikës, sheshi i Xhamisë, rruga e Mborjes, rruga e Ravonikut	28.04.2015	14.04.2016	235.502.224
7.	Rikonstruksion fasadash, catish, riveshje të mureve në qendër Tamarë	28.08.2015	25.05.2016	43.552.472
8.	Rikonstruksion i rrugës industriale pranë terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë	8.3.2019	21.06.2019	34.613.328
9.	Rehabilitim i Digës së Gjocaj në HEC Vau i Dejës	13.09.2018	21.12.2018	23.852.492

Nëse do të ti referohemi kriterit 2.3.1.a për kualifikim kërkohen një kontratë të ngjashme me vlerë minimalisht 229.143.409,33 lekë pa tvsh.

Në plotësim të kësaj kërkesë ne kemi paraqitur dy kontrata të ngjashme, me vlerat respektive si më poshtë:

1.	Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik Belsh – Dragot – Kuçovë-Urë Vajgurore (Segmenti degëzim Grekan – Dragot)	29.05.2017	22.12.2017	318.219.526
2.	Sistemim asfaltim i rrugës së unazës “Poliklinikë – 7 pallatet”, Vlorë	06.07.2016	05.07.2017	294.738.985

Në arsyetimin e KVO nuk i konsideron kontrata të ngjashme sepse nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji.

Ky është një arsyetim i pa bazuar por vetëm i nisur nga interesa tuaja të ngushta. Të dyja kontratat e paraqitura përmbushin kërkesat si në madhësi, në metodologji dhe teknologji.

Nëse do ti referohemi kriterit të kualifikimit 2.3.1

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ne kemi paraqitur për të përmbushur këtë kriter 9 kontrata të ngjashme me natyrë punimesh të ndryshme përfshi edhe punimet në mjedis ujore.

Kriteri 2.3.1 – b) kërkon të paraqiten punë të ngjashme vlera monetare totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit (458.286.818,65 lekë pa tvsh) pra 916.573.636 lekë pa tvsh.

Për të plotësuar këtë kriter ne kemi paraqitur 9 kontrata të ngjashme me vlerë totale të punimeve 1.052.062.634 lekë pa tvsh. Pra kriteri i kualifikimit 2.3.1.-b) përmbushet më së miri.

- Operatori në bashkim “Xhengo” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e licencave në pikën 2.3.4, nuk ka paraqitur licencën NP – 8 C për punime në det, pasi ka marrë përsipër punime betoni pr shkallaret në det.

2. Sqarime në lidhje me arsyet e skualifikimit të dhëna nga autoriteti kontraktor:

Konstatimi i bërë nga KVO nuk është i vërtet. KVO nuk mund të jetë kaq e verbër sa të mos shoh edhe këtë gjë që është kaq e qartë në ndarjen që ne i kemi bërë punimeve midis dy operatorëve ekonomikë.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis dy operatorëve ekonomikë shoqëria “Xhengo” sh.p.k. nuk ka marrë përsipër punimet e betonit për shkallët në det.

Referuar preventivit punimet e betonit për shkallët në det janë në zërin e punimeve III- punime betoni dhe beton arme, nënzëri 4 i punimeve

4.	Ana.9	Beton C25/30 – Shkallët në det	m3		9,000.00
----	-------	--------------------------------	----	--	----------

Në kontratën e bashkëpunimit të lidhur midis operatorëve ekonomikë Tabela 2, përshkruan punimet që ka marrë përsipër shoqëria “Xhengo” sh.p.k. dhe në këtë tabelë (tabelën 2), ky zë punimesh është me vlerën “ZERO”.

III. PUNIME BETONI DHE BETON ARME						
1	2.262/3	Nenshtrese Beton C12/15	m3	89.90	8,000.00	719,200.00
2	Ana.7	Beton C30/37 - Bazament per muret	m3		9,000.00	-
3	Ana.8	Beton C25/30- Muret mbajtjes	m3		9,000.00	-
4	Ana.9	Beton C25/30 - Shkallat ne det	m3		9,000.00	-
5	Ana.10	Beton 1 bardhe C30/37 - shkalla e parapetet	m3		11,000.00	-
6	Ana.11	Beton 1 bardhe C25/30 - Kollonat	m3		9,000.00	-
7	Ana.12	Beton 1 bardhe C25/30 - Traret ne +6.308	m3		9,000.00	-
8	Ana.13	Shtrese betoni C20/25 mbi dhomen teknike te pishines	m3	38.50	9,000.00	346,500.00
9	Ana.14	Beton C25/30 - Soleta 10 cm me beton te furçuar	m3		11,000.00	-
10	Ana.15	Beton C20/25 - Beton me pigment te zi per murin ballor dhe stolin	m3	150.00	11,000.00	1,650,000.00
11	Ana.16	Beton C30/37 -per soleta te plota.	m3		9,000.00	-
12	Ana.17	Beton C30/37 - Beton me pigment te zi ne U'Injeksion	m3	7.70	11,000.00	84,700.00

*Këtë zë punimesh Beton C 25/30 – shkallët në det, e ka marrë përsipër shoqëria “Curri” sh.p.k. Referohuni faqes 6 të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para noterit.lik.*

*Me këtë vlerësim skandaloz dhe të pambështetur në ligj, KVO ka favorizuar një ofertë tjetër me vlerë 28 milion lekë të reja më shumë. Ky është një dëm ekonomik i pafalshëm që i bëhet fondeve të buxhetit të shtetit.*

*[...]*

*Ne kërkojmë kuotimin e ofertës tonë në këtë procedurë prokurimi[...].*

II.3.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 03.10.2019, me anë të shkresës nr.1392/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se ka marrë dijëni në lidhje me kthimin e përgjigjes në datë 05.10.2019. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

*[...]*

- 1. Në lidhje me pretendimin e parë të parashtruar nga operatori ekonomik ankimues KSHA vëren se:*

*Më datë 24.09.2019 BOE “Curri” sh.p.k. & “Xhengo” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e këtij bashkimi në këtë procedurë prokurimi për arsye se shoqëria në bashkim “Curri” shpk nuk plotëson kriterin e kontratës së ngjashme.*

*Në dokumentat standarde të tenderit në shtojcën 12 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, në pikën 2.3. “Kapaciteti teknik” është kërkuar: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatori/et ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga autoriteti kontraktor si më poshtë: “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (229.143.409,33 lekë pa tvsh) të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe / ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik”.*

*Nga verifikimi KSHA konstaton se:*

- a. Kontrata e paraqitur prej OE “Curri” sh.p.k. nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është Shëtitore dhe ambiente rekreacioni, infrastrukturë ndihmëse në funksion të këtyre ambienteve (si sisteme vaditje, furnizimi me ujë dhe kanalizime, punime / instalime pajisje elektro – mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, një kontratë për punime rifiniturash në ndërhyrje në fasada dhe riveshje të mureve dhe një kontratë për rehabilitim të digave. Detaje të vlerësimit jepen në tabelën 1.*

- b. Me referencë në Vendim nr. 354, datë 11/5/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, punimet për objektin e prokurimit bëjnë pjesë në seksionin II Strukturat në Ambientet e jashte dhe pjesërisht në Seksionin III Vepra inxhinierike, ndërsa kontrata e ngjashme të paraqitura nga OE karakterizohen në Seksionin IV Strukturat e transportit dhe qarkullimit.
- c. Pas shqyrtimit të preventivave përkatës u vu re që punimet e objektit të prokurimit janë të ndryshëm me ato të punimeve të kontratave të ngjashme paraqitur nga OE dhe mbi të gjitha ndryshon pesha specifike që kanë këto punime në vlerën totale të kontratës. Për të vënë në dukje natyrën specifike të punimeve konkretisht në preventivat e paraqitura si punë të ngjashme peshën kryesore e zënë zërat e gërmim dhe mbushje për trup rruge, shtresat asfaltike, “guard rail” dhe sinjalistikë etj., ndërsa punimet e objektit të prokurimit sikurse më lart përmendur janë sisteme vaditje, furnizimi me ujë dhe kanalizime, punime/instalime pajisje elektro – mekanike, ndërtim trotuari me beton dekorativ, veshje për finiturën e pishinave, tubacione dhe rakorderi për pishinën etj.
- d. Ndryshimi i natyrës së punimeve të paraqitura nga OE ankimes për të ngjashme dhe atyre objekt i procedurës së prokurimit është i përcaktuar tashmë edhe në praktikën e konsoliduar disavjeçare të Komisionit të Prokurimit Publik duke përmendur vendimin nr. 615/2014 datë 27.11.2014 etj.

Neni 3 i ligjit 9643/2006 ka shprehur përkufizimin “Punim” është përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.

Neni 2 Parimet e përzgjedhjes “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mos-diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”.

Neni 20 citon [...]

Referuar nenit 26 pika 6/a/b të VKM 914/2014 parashikohet [...].

Në nenin 46 të LPP, pika 1 përcaktohet [...].

Neni 53 përcakton [...]. Neni 55 parashikon se [...].

Neni 26 i VKM 914/2014 përcakton [...].

Neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” ka parashikuar [...].

Neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” citon [...].

Referuar VKM 354 datë 11/05/2016, neu 2 parashikon [...].

Seksioni II “Strukturat në Ambientet e Jashtme” neni 30 “Parimet e tarifave”: “1. Përveç kostove të instalimeve në natyrë, kostot e llogaritshme, për shërbimet themelore për strukturat në ambientet e jashtme, në mënyrë specifike përfshijnë kostot për strukturat dhe projektet e mëposhtme, ku ofruesi i shërbimit merr përsipër planifikimin e tyre teknik dhe / ose mbikëqyr realizimin e tyre: i) rrjedhave ujore të vetme me elemente të konsiderueshme ekologjike dhe të peizazhit; ii) pellgjeve ujëmbledhëse; iii) punime tokësore në shkallë të gjerë si pjesë e projektimit të peizazhit; iv) prejrrje të thjeshta dhe përforcime si një mjet për projektimin e peizazhit nëse kërkohet mbikqyrje e përcaktuar në Kreun IV; v) barriera zhurma izoluese si një mjet për projektimin e peizazhit;



vi) strukturat për mbajtjen e ngarkesave dhe për përforcimin e tokës, mbështetjet pa ngarkesën e trafikut, si një mjet për projektimin e peisazhit nëse nuk kërkon shërbime të përcaktuara në Kreun IV; vii) rrugë – kalimet dhe urat nëse nuk kërkon shërbimet e përcaktuara në Kreun IV; viii) rrugët e papërshtatshme për trafikun e rregullt të makinave me objekte të thjeshta të kullimit plus rrugët e tjera dhe sipërfaqet e shtruara të planifikuara si karakteristika të projektimit të strukturat në ambient të jashtëm të cilat nuk kërkojnë shërbime të përcaktuara në Kreun III”.

Në vijim nuk përfshihen në kostot e llogaritshme strukturat në ambientet e jashtme: i) ndërtesa dhe shpenzimet e listuara në nenin 23, pika 3; ii) punë për themelet dhe sipërfaqet e përfunduara të zonave të këmbësorëve duke përjashtuar kostot e shtrimit të sipërfaqes.

Seksioni III “Vepra inxhinierike” neni 34 “Fusha e veprimit” veprat inxhinierike përfshijnë: 1. Strukturat dhe objektet për furnizim me ujë; 2. Strukturat dhe objektet për largimin e ujërave të ndotura; 3. Strukturat dhe objektet për inxhinieri hidraulike, përveç objekteve të hapura të përcaktuara në nenin 2, pika 11; 4. Strukturat dhe objektet për furnizimin dhe largimin e gazrave dhe trupat e ngurtë duke përfshirë ndotësit e ujit, lëngje me përjashtim të objekteve të përcaktuara në nenin 52; 5. Strukturat dhe objektet për depozitimin e mbeturinave; 6. Objekte inxhinierike për shërbime transporti dhe qarkullim; 7. Projekte të tjera individuale me përjashtim të ndërtesave dhe antenave të transmetimit.

Seksioni IV “Struktura e transportit dhe qarkullimit” neni 40 fusha e veprimit, strukturat e transportit përfshijnë: “1. Strukturat e trafikut rrugor dhe sinjalistikës me përjashtim të rrugëve të bicikletave, shtigjeve apo hapësirave të jashtme siç përcaktohet në nenin , pika 11.2. Strukturat e trafikut hekurudhor. 3. Strukturat e trafikut ajror.

[...].

Përsa më sipër pretendimi nuk qëndron.

2. Lidhur me pretendimin e dytë, KSHA konstaton se në DT në pikën 2.3.4 “Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës” është parashikuar shprehimisht: Punime të përgjithshme ndërtimi

1. NP – 1 B Punime gjurmimi në tokë
2. NP – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
3. NP – 5 C Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
4. NP – 7 A Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
5. NP – 8 C Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë
6. NP – 11 B Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve etj
7. NP – 12 B Punime të inxhinierisë së Mjedisit”

Në lidhje me arsyen e skualifikimit nga operatori ekonomik në bashkim “Xhengo” shpk nuk përmbush kriterin e licencave në pikën 2.3.4 nuk ka paraqitur licencën NP – 8 C me emërtim kategorie “Ndërtime Detare dhe punime thellimi në ujë”, Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon se nisur nga natyra e objektit dhe vendndodhja e tij përgjatë vijës bregdetare të gjitha punimet që do të kryhen për përfundimin e objektit duhet të kryhen nga kompani që kanë eksperiencë për punime në det dhe rrjedhimisht duhet të jenë të pajisura me licencën përkatëse. Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë ndër të tjera edhe një pjesë të punimeve të (i) gjurmimit, (ii) shtresave dhe (iii) nënshtresave si dhe punimeve të

(iv) betonit/beton arme punimet të cilat për objektin e shëtitorës së Vlorës (lungomares) kryhen përgjatë vijës bregdetare. Kjo e fundit ka qenë edhe arsyeja pse autoriteti kontraktor ka përcaktuar këtë pikë të licencës profesionale NP – 8 C, të cilën duhet të përmbushin operatorët ekonomikë si kriter kualifikimi dhe më pas zbatimit të punimeve.

Në vijim sqarohet se bazuar në nenet 58 dhe 78 të VKM 914/2014 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesave ushtrojnë detyrën e tyre sipas parashikimeve dhe tagrave të dhëna në legjislacionin përkatës.

Ky legjislacion në tërësinë e tij parashikon gjithashtu të drejtën e ushtrimit të detyrave në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo ndikimi për anëtarët e KVO dhe KSHA ndaj dhe çdo përpjekje për të ndikuar në procesin e vlerësimit nëpërmjet presionit ose mënyrave të tjera është i dënueshëm me ligj. Në këtë kuadër sigurojmë operatorët ekonomikë ankimues se në çdo rast kur presione ose metoda të tilla do të konstatohen se ushtrohen ndaj anëtarëve të KVO ose KSHA autoriteti kontraktor do të jetë i detyruar të marrë masat përkatëse duke ndjekur rrugët dhe mjetet e duhura ligjore, civile, administrative dhe penale me qëllim ndalimin dhe mospërsëritjen e metodave të tilla nga persona të brendshëm apo të jashtëm të procesit të prokurimit.

Sipas nenit 74 të VKM 914/2014 citon [...].

Në ligjin 9643/2006, neni 46 pika 1, gërma b, parashikohet [...].

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

II.3.3. Në datën 11.10.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Xhengo” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si me poshte vijon:  
[...]

1. Sqarime në lidhje me arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor:

Referuar kërkesa për kualifikimi sipas DST:

2.3. Për kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga autoriteti kontraktor si më poshtë:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (229.143.409,33 lekë pa tvsh) të realizuar nga operatorë ekonomikë gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet..

plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Mbështetur në këto kërkesa, ne kemi ngarkuar në këtë procedurë prokurimi këto objekte të ngjashme:

<i>Nr.</i>	<i>OBJEKTI I KONTRATËS</i>	<i>DATA E FILLIMIT</i>	<i>DATA E PËRFUNDIMIT</i>	<i>VLERA PA TVSH</i>
1.	<i>Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rr. Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Rr. Anesti Lubonja, si dhe tek ish Pista e Aviacionit, Njësia Bashkiake nr. 7</i>	<i>09.05.2016</i>	<i>27.10.2016</i>	<i>79.785.725</i>
2.	<i>Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik Belsh – Dragot – Kuçovë-Urë Vajgurore (Segmenti degëzim Grekan – Dragot)</i>	<i>29.05.2017</i>	<i>22.12.2017</i>	<i>318.219.526</i>
3.	<i>Ndërtimi i urës së Lushës mbi Lumin Drin, Komuna Arras</i>	<i>09.07.2015</i>	<i>20.12.2016</i>	<i>59.706.577</i>
4.	<i>Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman</i>	<i>18.10.2017</i>	<i>20.06.2018</i>	<i>266.141.390</i>
5.	<i>Sistemim asfaltim i rrugës së unazës “Poliklinikë – 7 pallatet”, Vlorë</i>	<i>06.07.2016</i>	<i>05.07.2017</i>	<i>346.751.747</i>
6.	<i>Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku, sheshi i Poliklinikës, sheshi i Xhamisë, rruga e Mborjes, rruga e Ravonikut</i>	<i>28.04.2015</i>	<i>14.04.2016</i>	<i>235.502.224</i>
7.	<i>Rikonstruksion fasadash, catish, riveshje të mureve në qendër Tamarë</i>	<i>28.08.2015</i>	<i>25.05.2016</i>	<i>43.552.472</i>
8.	<i>Rikonstruksion i rrugës industriale pranë terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë</i>	<i>8.3.2019</i>	<i>21.06.2019</i>	<i>34.613.328</i>
9.	<i>Rehabilitim i Digës së Gjocaj në HEC Vau i Dejës</i>	<i>13.09.2018</i>	<i>21.12.2018</i>	<i>23.852.492</i>

*Nëse do të ti referohemi kriterit 2.3.1.a për kualifikim kërkohen një kontratë të ngjashme me vlerë minimalisht 229.143.409,33 lekë pa tvsh.*

*Nëse do të ti referohemi kriterit 2.3.1.b për kualifikim vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se shuma e kontratave të ngjashme 916.573.636 lekë pa tvsh.*

*Neni 26 i VKM 914/2014 “Për rregullat e prokurimit publik” {...}.*

*Dispozita e mësipërme në VKM 914/2014 e përcakton në mënyrë të qartë dhe pa ekuivok se cili do të konsiderohet kriter i plotësuar për punët e ngjashme për të provuar përvojën e ngjashme. Autoriteti kontraktor ngatërron konceptin e “punëve të ngjashme” me “punë identike” kur citon se ne si operator plotësojmë kriterin e afatit dhe të vlerës së kontratave por jo atë të ngjashmërisë. Autoriteti kontraktor në mënyrë të gabuar shprehet se kriteri për punë të ngjashme lidhet me metodologjinë, teknologjinë dhe kompleksitetin e kontratës.*

*Ndërkohë legjislatori në nenin 46/b të ligjit 9643/2006 “Për prokurimin publik” për vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh se çdo objekt prokurimi në vetvete është i ndryshëm dhe kompleks por operatorët ekonomikë duhet të krijojnë bindje tek autoriteti kontraktor që mund të realizojnë punë të tilla publike nisur nga eksperiencia të mëparshme të ngjashme por jo domosdoshmërisht identike.*

*Gjithashtu vlen të theksohet se autoriteti kontraktor rishtazi dhe me iniciativën e tij si dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore, ka vendosur kriterin e punëve identike si kusht kumulativ për vlefshmërinë e punëve të ngjashme. Ngjashmëria e kontratave do të vlerësohet në kompleks dhe në harmoni me objektin dhe punimet konkrete të kontratave të përfunduara nga operatori ekonomik. Për punimet specifike të parashikuara në projekt, të cilat sipas autoritetit kontraktor kërkojnë metodologji, teknologji të veçantë shoqëria “Curri” ka paraqitur licencat përkatëse të cilat vetë autoriteti kontraktor i ka vlerësuar dhe i ka pranuar.*

*Nga autoriteti kontraktor është arritur në përfundim të gabuar se bashkimi i shoqërive “Curri” shpk dhe shoqëria “Xhengo” shpk nuk plotëson kriterin e kontratave të ngjashme.*

*Për plotësimin e kriterit të eksperiencës së ngjashme kërkojmë nga Komisioni i Prokurimit Publik thirrjen e një eksperti të fushës së ndërtimit.*

*Ky bashkim operatorësh ka plotësuar kriterin e punëve të ngjashme me të dy kriteret e vendosura në DST edhe pse mjafton vetëm njëri.*

*Nëse do të ti referohemi plotësimin të kriterit të kualifikimit 2.3.1.a të DST*

- a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Shoqëria “Curri” si lider i këtij BOE e ka plotësuar këtë kriter me paraqitjen e më shumë se një kontrate të ngjashme me vlerë mbi 50% të vlerës së fondit limit.*

- 1. Kontrata me objekt “Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik Belsh – Dragot – Kuçovë- Urë Vajgurore (Segmenti Degëzim Grekan – Dragot)”, e cila është pranuar nga KSHA si një kontratë brenda afatit 3 vjeçar dhe me vlerën e kërkuar sipas DST sa më sipër, në shumën 318.219.526 lekë pa tvsh por se në mënyrë të pabazuar nuk e vlerëson atë si punë të ngjashme.*

Gjithashtu kemi paraqitur edhe kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Unazës “Poliklinika – 7 pallatet”, Vlorë”, e cila është pranuar nga KSHA si një kontratë brenda afatit 3 vjeçar dhe me vlerën e kërkuar sipas DST sa më sipër, në shumën 294.738.985 lekë pa tvsh por se në mënyrë të pabazuar KVO dhe KSHA pranë autoritetit kontraktor nuk e vlerëson atë si punë të ngjashme.

Të dyja kontratat e mësipërme të paraqitura nga shoqëria “Curri” në procedurën e prokurimit si kriter teknik për eksperiencë dhe përvojë të shoqërisë janë kontrata të cilat në kompleksitetin e tyre janë punë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Nëse do ti referohemi kriterit të kualifikimit 2.3.1.b. të DST

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ne kemi paraqitur për të përmbushur këtë kriter 9 kontrata të ngjashme të shoqërisë “Curri” dhe 1 kontratë të BOE “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. për të cilën Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk e ka përfshirë fare në tabelën bashkëlidhur përgjigjes.

Nga vlerësimi i bërë nga KVO e autoritetit kontraktor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me kriterin e punëve të ngjashme, në asnjë nga 10 kontratat e ngjashme të paraqitura nga BOE nuk plotësohet kriteri i aftësisë teknike për eksperiencë të ngjashme.

Sipas përgjigjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 1392/1 të datës 03.10.2019 kriteri 2.3.1. – b) kërkohej të paraqiten punë të ngjashme vlera monetare totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit (458.286.818,65 lekë pa tvsh) pra 916.573.636 lekë pa tvsh.

Gjithashtu në mënyrë të gabuar vlerësohet nga KVO dhe arsyetohet nga KSHA se kontrata me objekt “Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rr. Durrësit, Teodor Keko, lumi Lana, Rr. Anesit Lubonja”, si dhe tek ish pista e Aviacionit, Njësia Bashkiake nr. 7”, është jashtë afatit 3 vjeçar.

Referuar datës së përfundimit të kontratës është 23.09.2016 data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 12.09.2019. Pra referuar afatit të përcaktuar në legjislacionin për prokurimin dhe dokumentat e tenderit kontrata është brenda afatit 3 vjeçar.

Në mënyrë të gabuar vlerësohet nga KVO dhe arsyetohet nga KSHA se kontrata me objekt “Ndërtim i urës së Lushës mbi lumin Drin, Komuna Arras”, është jashtë afatit tre vjeçar. Referuar datës së përfundimit të kontratës është 20.12.2016 datë e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 12.09.2019. Pra referuar afatit të përcaktuar në legjislacionin për prokurimin dhe dokumentat e tenderit kontrata është brenda afatit tre vjeçar.

Po të bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë të kontratave të cilat janë të ngjashme dhe brenda afatit 3 vjeçar atëherë shuma e tyre do të jetë 918.791.521 lekë pa tvsh pra dukshëm më shumë se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Të gjithë objektet e këtyre kontratave janë komplekse dhe përfshijnë Ndërtim rruge, rikonstruksion rruge, sistemim e mobilim urban, shtrim pllakash, asfaltim, rikonstruksion fasadash, rehabilitim i digave etj.

Gjithashtu në arsyetimin e tij në lidhje me natyrën dhe ngjashmërinë e punimeve, autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim. Kjo është absurde dhe totalisht e gabuar dhe nuk ka lidhje me punimet e zbatimit të parashikuara në preventivin e punimeve. VKM nr. 354, datë 11.05.2016 është një manual tarifash për shërbimet dhe tipologjitë e ndryshme të shërbimeve, në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.

- Operatori në bashkim “Xhengo” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e licencave në pikën 2.3.4, nuk ka paraqitur licencën NP – 8 C për punime në det, pasi ka marrë përsipër punime betoni pr shkallaret në det.

Në lidhje me këtë arsye skualifikimi, autoriteti kontraktor ka dy qëndrime të ndryshme që dallojnë nga njëra tjetra.

a) Në arsyetimin e dhënë në platformën elektronike të APP ka thënë:

...Operatori në bashkim “Xhengo” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e licencave në pikën 2.3.4, nuk ka paraqitur licencën NP – 8 C për punime në det, pasi ka marrë përsipër punime betoni për shkallaret në det.

Për këtë arsyetim e kemi sqaruar që është i gabuar pasi shoqëria “Xhengo” sh.p.k. nuk ka marrë punime betoni për shkallaret në det.

b) Në arsyetimin e dhënë në përgjigje të ankesës tonë ka arsyetuar si më poshtë:

.... Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se nisur nga natyra e objektit dhe vendndodhja e tij përgjatë vijës bregdetare, të gjitha punimet që do të kryhen për përfundimin e objektit duhet të kryhen nga kompani që kanë eksperiencë për punime në det dhe rrjedhimisht duhet të jenë pajisur me licencën përkatëse.

..... Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë ndëry të tjera dhe një pjesë të punimeve të (i) ..... Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë ndëry të tjera dhe një pjesë të punimeve të (i) ..... Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë ndëry të tjera dhe një pjesë të punimeve të (i) gërmimit, (ii) shtresave dhe (iii) nënshtresave, si dhe punime të (iv) betonit/betonarme, punime të cilat për objektin e shëtitores së Vlorës (Lungomare) kryhen përgjatë vijës bregdetare. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse autoriteti kontraktor ka përcaktuar këtë pikë të licencës profesionale “NP – 8C” të cilën duhet ta përmbushin operatorët ekonomikë si kriter kualifikimi dhe më pas zbatimit të punimeve.

2. Sqarime në lidhje me arsyet e skualifikimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktor:

Së pari: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nuk mund të gjykojë, por ka për detyrë të vlerësojë atë çfarë është kërkuar në DST, atë çfarë kërkon ligji dhe si është pasqyruar respektimi i kërkesave ligjore në vlerësimin e ofertës së ofertuesit.

Së dyti: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka tagrin të gjykojë për kryerjen e punimeve dhe për përfundimin e objektit dhe aq më keq që të përcaktojë edhe që “të kryhen nga kompani që kanë eksperiencë për punime në det”. Kjo është jashtë kompetencave të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Këtë e ezauron vendosja e kriterit të kualifikimit për zotërimin e licencës profesionale të kategorisë “NP -8”, klasifikimi C.

Së treti: Dhe në vijim, për plotësimin e këtij kriteri BOE “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. kanë bashkuar kapacitetet profesionale, teknike dhe ekonomike për plotësimin e këtij kriteri. Kërkesa për zotërimin e kësaj pike nuk është që këtë licencë duhet të zotërojnë operatorët ekonomikë të një BOE por duhet ta zotërojnë ofertuesit, që në këtë rast është BOE “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. dhe zotëruesi i kësaj licence NP – 8 C është shoqëria “Curri” sh.p.k.

Së katërti: siç edhe e kemi sqaruar në ankesën tonë drejtuar autoritetit kontraktor, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis dy operatorëve ekonomikë, shoqëri “Xhengo” sh.p.k. nuk ka marrë përsipër punimet e betonit për shkallët në det.

Referuar preventivit, punimet e betonit për shkallët në det janë në zërin e Punimeve III- Punime betoni dhe beton arme, nënzëri 4 i punimeve:

4.	Ana.9	Beton C25/30 – Shkallët në det	m3		9,000.00
----	-------	--------------------------------	----	--	----------

Në kontratën e bashkëpunimit të lidhur midis operatorëve ekonomikë Tabela 2, përshkruan punimet që ka marrë përsipër shoqëria “Xhengo” sh.p.k. dhe në këtë tabelë (tabelën 2), ky zë punimesh është me vlerën “ZERO”.

III. PUNIME BETONI DHE BETON ARME						
1	2.262/3	Nenshtrese Beton C12/15	m3	89.90	8,000.00	719,200.00
2	Ana.7	Beton C30/37 - Bazament per muret	m3		9,000.00	-
3	Ana.8	Beton C25/30- Muret mbaytes	m3		9,000.00	-
4	Ana.9	Beton C25/30 - Shkallët në det	m3		9,000.00	-
5	Ana.10	Beton I bardhe C30/37 - shkalla e parapetjet	m3		11,000.00	-
6	Ana.11	Beton I bardhe C25/30 - Kollonat	m3		9,000.00	-
7	Ana.12	Beton I bardhe C25/30 - Traret në +6.308	m3		9,000.00	-
8	Ana.13	Shtrese betoni C20/25 mbi dhomen teknike te pishines	m3	38.50	9,000.00	346,500.00
9	Ana.14	Beton C25/30 - Soleta 10 cm me beton te furqar	m3		11,000.00	-
10	Ana.15	Beton C20/25 - Beton me pigment te zi per murin ballor dhe stolin	m3	150.00	11,000.00	1,650,000.00
11	Ana.16	Beton C30/37 -per soleta te plota	m3		9,000.00	-
17	Ana.17	Beton C30/37 - Beton me pigment te zi per Vllazet	m3		11,000.00	121,000.00

Këtë zë punimesh Beton C 25/30 – shkallët në det, e ka marrë përsipër shoqëria “Curri” sh.p.k. Referohuni faqes 6 të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para noterit.

Por siç edhe thamë më lart, autoriteti kontraktor nëpërmjet KSHA ka ndryshuar mënyrën e arsytimit për këtë skualifikim të bërë për këtë pikë.

Të nderuar anëtarë të KPP:

Ky vlerësimi i bërë nga KVO, më pas i lënë në fuqi dhe nga titullari i autoritetit kontraktor, nuk është aspak profesionale, është i pambështetur në ligj dhe totalisht në kundërshtim me frymën dhe parimet e ligjit të prokurimit publik.

Autoriteti kontraktor ka cënuar rëndë parimet e sanksionuara në ligjin 9643/2006 të cilat janë: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve:

b) transparencë në procedurat e prokurimit: c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Ndërkohë që duam tju bëjmë me dije se shoqëria e kualifikuar e parë ndonëse me vlerë rreth 30 milion lekë të reja më shumë se oferta jonë, ka disa kontrata sipërmarrje në realizim e sipër dhe kapacitete teknike dhe makineritë i ka të angazhuara në to, përfshi këti edhe me autoritetin kontraktor FSHZH.

Por kjo nuk e ka penguar autoritetin kontraktor që ta kualifikojë si ofertës fituese ndonëse kjo ofertë është rreth 30 milion lekë më e lartë. KPP është e lutur të verifikojë këtë informacion dhe të nxjerrë përfundimet e saj në vlerësimin e ankesës sonë.

Shoqëria “Curri” sh.p.k. është një shoqëri lider në fushën e ndërimeve dhe pjesëmarrëse e rregullt në procedurat e prokurimit të organizuara nga autoritete të ndryshme kontraktore. Kjo shoqëri ndër vite ka rezultuar e suksesshme në procedurat e prokurimit, ka nënshkruar me qindra kontrata sipërmarrje dhe ka finalizuar objekte dhe punë të një cilësie të lartë dhe me standarte bashkëkohore.

Kërkojmë:

Pranimin e kërkesës

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së autoritetit kontraktor

Kualifikimin e “Curri” & “Xhengo” shpk

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 1392/4 prot., datë 15.10.2019, protokolluar me tonën në datën 15.10.2019, me objekt “Informacion lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Vazhdimi i Shëtitorës së Vlorës – Segmenti Jugor nga Fusha e Sportit deri tek Tuneli”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Xhengo” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “Operatori në bashkim “Curri” sh.p.k. nuk përmbush kriterin në pikën 2.3.1 “Përvojë të suksesshme për kontrata të ngjashme”. Punët e prezantura nga operatori ekonomi “Curri” sh.p.k. të cilat mund të konsiderohen të ngjashme nuk përmbushin vlerën e cila kërkohet nga ky operator ekonomik si pjesëtar me pjesëmarrjen më të madhe në JV. Kontrata “Rikonstruksioni i Rrugës Cërrik - Belsh - Dragot” me vlerë 318,219,525 lekë pa TVSH, nuk mund të konsiderohet kontratë e ngjashme, pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji. Kontrata “Rikonstruksioni i Shëtitorës së Vlorës” do të



zhvillohet në një ambjent kompleks urban, për më tepër, natyra e punëve të parashikuara në këtë kontratë, përfshin metodologji dhe teknologji të lidhura me rikualifikimin urban. Gjithashtu në këtë kontratë nuk janë përfshirë punime asfalti por vetëm shtrime pllakash, ndriçim dhe mobilim urban, punime të cilat nuk janë prezent në kontratën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k “Rikonstruksioni i Rrugës Cerrik - Belsh - Dragot”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, në përbërje të të cilit ka edhe ekspert të fushës përkatëse për të cilën ngrihen pretendime, vërehet se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 12, pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, pika 2.3.1. nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

**2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (229,143,409.33 leke pa tvsh) të realizuar nga operatorie ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

**Ose**

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikaten e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Lejen e ndërtimit
3. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
4. Situacionin përfundimtar të objektit;
5. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.
6. Akt kolaudimi objekti;
7. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;

*Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

III.1.2. Në dokumentat e tenderit është përcaktuar preventivi që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë të interesuar, i cili përbëhet nga zërat e nënzërat si më poshtë vijon:

- I. PUNIME PRISHJEJE & GËRMIMI
- II. PUNIME NËNSHTRESASH
- III. PUNIME BETONI DHE BETON ARME
- IV. PUNIME SHTRRESASH
- V. TJERA
- VI. PUNIME NË GJELBËRIM
- VIII. PUNIME ELEKTRIKE
- IX. MAKINERI DHE PAISJE

#### **I. PUNIME PRISHJEJE & GËRMIMI**

1. Prishje struktura betonarmeje + transport
2. Prishje mur guri
3. Çmontim parmak çeliku + transport
4. Prishje trotuari me beton dekorativ të derdhur + transport
5. Heqje shtyllash ndriçimi + dorëzim në bashki 12m të larta
6. Çmontim dysheme dërrase + transport
7. Heqje dhe depozitim në kantier i gurëve të medhenj.
8. Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet
9. Gërmim dheu në seksion të lirë me krahë, në tokë të butë, kateg. I-II, trans. K d deri 10m
10. Transport materiale të ndryshme deri 10 km m<sup>3</sup>
11. Heqje pemësh dhe dorëzim në bashki

#### **II. PUNIME NËNSHTRESASH**

1. Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri
2. Shtresë stabilizant t=20cm
3. Shtresë stabilizant t=15cm

#### **III. PUNIME BETONI DHE BETON ARME**

1. Nenshtrese Beton C12/15
2. Beton C30/37 - Bazament per muret
3. Beton C25/30- Muret mbajtes
4. Beton C25/30 - Shkallet ne det
5. Beton I bardhe C30/37 - shkalla e parapetet
6. Beton I bardhe C25/30 - Kollonat
7. Beton I bardhe C25/30 - Traret ne +6.308
8. Shtrese betoni C20/25 mbi dhomen teknike te pishines
9. Beton C25/30 - Soleta 10 cm me beton te furçuar
10. Beton C20/25 - Beton me pigment te zi per murin ballor dhe stolin
11. Beton C30/37 -per soleta te plota.

12. Beton C20/25 - Beton me pigment te zi per Klaustrat
13. Beton C30/37 me pigment te zi - Kollona
14. Beton C25/30 - Soleta b/a 18 cm & traret rigjidues perimetrare
15. Beton C25/30 - Traret e themelit
16. Çelik armimi B500b  $\phi$  6-10mm ton
17. Çelik armimi B500b  $> \phi$  10mm ton
18. F V bordura betoni 25x35 cm
19. Beton C30/37- Muret mbajtes

#### IV. PUNIME SHITESASH

1. Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka
2. Ndërtim trotuari me beton dekorativ që në sipërfaqe ka pllaka zalli deri në 10cm diameter
3. Ndërtim shtrese betoni arkitektonik me finiturë çimento e kuarc i furçuar  $t=18\text{cm}$  m2
4. Ndërtim shtrese betoni për rampë me finiturë çimento + kuarc, kuriz peshku
5. Ndërtim shtrese me beton dekorativ brenda rampës
6. Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
7. Shtrese binderi me granil gur kave, 10cm, me mak.
8. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama
9. Shtresë mbrojtëse e hidroizolimit

#### V. TJERA

1. F.V.Parmak metalik inoksi në hapësira e shkallë
2. F.V.Rërë për plazhin - 20cm
3. F.V.zhavor për plazhin -30cm
4. F.V Shkëmbinjsh
5. Zgarë tërthore për mbledhje uji çelik i galvanizuar
6. Granil I zi traktolit I Lezhës 8 cm
7. Ndërtim bordurë betoni  $t=15\text{cm}$  me lamë 50mm të fiksuar sipër
8. Veshje me kurasanit të zi për finituren e pishinave
*Ky bashkim operatorësh ka plotësuar kriterin e punëve të ngjashme me të dy kriteret e vendosura në DST edhe pse mjafton vetëm njëri.*

*Nëse do të referohemi plotësimin të kriterit të kualifikimit 2.3.1.a të DST*

*b) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Shoqëria “Curri” si lider i këtij BOE e ka plotësuar këtë kriter me paraqitjen e më shumë se një kontrate të ngjashme me vlerë mbi 50% të vlerës së fondit limit.*



1. Kontrata me objekt “Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik Belsh – Dragot – Kuçovë- Urë Vajgurore (Segmenti Degëzim Grekan – Dragot)”, e cila është pranuar nga KSHA si një kontratë brenda afatit 3 vjeçar dhe me vlerën e kërkuar sipas DST sa më sipër, në shumën 318.219.526 lekë pa tvsh por se në mënyrë të pabazuar nuk e vlerëson atë si punë të ngjashme.

Gjithashtu kemi paraqitur edhe kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Unazës “Poliklinika – 7 pallatet”, Vlorë”, e cila është pranuar nga KSHA si një kontratë brenda afatit 3 vjeçar dhe me vlerën e kërkuar sipas DST sa më sipër, në shumën 294.738.985 lekë pa tvsh por se në mënyrë të pabazuar KVO dhe KSHA pranë autoritetit kontraktor nuk e vlerëson atë si punë të ngjashme.

Të dyja kontratat e mësipërme të paraqitura nga shoqëria “Curri” në procedurën e prokurimit si kriter teknik për eksperiencë dhe përvojë të shoqërisë janë kontrata të cilat në kompleksitetin e tyre janë punë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Nëse do ti referohemi kriterit të kualifikimit 2.3.1.b. të DST

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ne kemi paraqitur për të përmbushur këtë kriter 9 kontrata të ngjashme të shoqërisë “Curri” dhe 1 kontratë të BOE “Curri” sh.p.k. dhe “Xhengo” sh.p.k. për të cilën Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk e ka përfshirë fare në tabelën bashkëlidhur përgjigjes.

Nga vlerësimi i bërë nga KVO e autoritetit kontraktor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me kriterin e punëve të ngjashme, në asnjë nga 10 kontratat e ngjashme të paraqitura nga BOE nuk plotësohet kriteri i aftësisë teknike për eksperiencë të ngjashme.

Sipas përgjigjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 1392/1 të datës 03.10.2019 kriteri 2.3.1. – b) kërkohen të paraqiten punë të ngjashme vlera monetare totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit (458.286.818,65 lekë pa tvsh) pra 916.573.636 lekë pa tvsh. Gjithashtu në mënyrë të gabuar vlerësohet nga KVO dhe arsyetohet nga KSHA se kontrata me objekt “Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rr. Durrësit, Teodor Keko, lumi Lana, Rr. Anesit Lubonja”, si dhe tek ish pista e Aviacionit, Njësia Bashkiake nr. 7”, është jashtë afatit 3 vjeçar.

Referuar datës së përfundimit të kontratës është 23.09.2016 data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 12.09.2019. Pra referuar afatit të përcaktuar në legjislacionin për prokurimin dhe dokumentat e tenderit kontrata është brenda afatit 3 vjeçar.

Në mënyrë të gabuar vlerësohet nga KVO dhe arsyetohet nga KSHA se kontrata me objekt “Ndërtim i urës së Lushës mbi lumin Drin, Komuna Arras”, është jashtë afatit tre vjeçar. Referuar datës së përfundimit të kontratës është 20.12.2016 datë e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 12.09.2019. Pra referuar afatit të përcaktuar në legjislacionin për prokurimin dhe dokumentat e tenderit kontrata është brenda afatit tre vjeçar.

Po të bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë të kontratave të cilat janë të ngjashme dhe brenda afatit 3 vjeçar atëherë shuma e tyre do të jetë 918.791.521 lekë pa tvsh pra dukshëm më shumë se dyfishi i vlerës së fondit limit.

*Të gjithë objektet e këtyre kontratave janë komplekse dhe përfshijnë Ndërtim rruge, rikonstruksion rruge, sistemim e mobilim urban, shtrim pllakash, asfaltim, rikonstruksion fasadash, rehabilitim i digave etj.*

*Gjithashtu në arsyetimin e tij në lidhje me natyrën dhe ngjashmërinë e punimeve, autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim. Kjo është absurde dhe totalisht e gabuar dhe nuk ka lidhje me punimet e zbatimit të parashikuara në preventivin e punimeve. VKM nr. 354, datë 11.05.2016 është një manual tarifash për shërbimet dhe tipologjitë e ndryshme të shërbimeve, në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.*

III.1.5. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se:

- a. *Kontrata e paraqitur prej OE “Curri” sh.p.k. nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në kompleksitet, metodologji dhe teknologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është Shëtitore dhe ambiente rekreacioni, infrastrukturë ndihmëse në funksion të këtyre ambienteve (si sisteme vaditje, furnizimi me ujë dhe kanalizime, punime / instalime pajisje elektro – mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, një kontratë për punime rifiniturash në ndërhyrje në fasada dhe riveshje të mureve dhe një kontratë për rehabilitim të digave. Detaje të vlerësimit jepen në tabelën 1.*
- b. *Me referencë në Vendim nr. 354, datë 11/5/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, punimet për objektin e prokurimit bëjnë pjesë në seksionin II Strukturat në Ambientet e jashte dhe pjesërisht në Seksionin III Vepra inxhinierike, ndërsa kontrata e ngjashme të paraqitura nga OE karakterizohen në Seksionin IV Strukturat e transportit dhe qarkullimit.*
- c. *Pas shqyrtimit të preventivave përkatës u vu re që punimet e objektit të prokurimit janë të ndryshëm me ato të punimeve të kontratave të ngjashme paraqitur nga OE dhe mbi të gjitha ndryshon pesha specifike që kanë këto punime në vlerën totale të kontratës. Për të vënë në dukje natyrën specifike të punimeve konkretisht në preventivat e paraqitura si punë të ngjashme peshën kryesore e zënë zërat e gërmim dhe mbushje për trup rruge, shtresat asfaltike, “guard rail” dhe sinjalistikë etj., ndërsa punimet e objektit të prokurimit sikurse më lart përmendur janë sisteme vaditje, furnizimi me ujë dhe kanalizime, punime/instalime pajisje elektro – mekanike, ndërtim trotuari me beton dekorativ, veshje për finiturën e pishinave, tubacione dhe rakorderi për pishinën etj.*
- d. *Ndryshimi i natyrës së punimeve të paraqitura nga OE ankimues për të ngjashme dhe atyre objekt i procedurës së prokurimit është i përcaktuar tashmë edhe në praktikën e konsoliduar disavjeçare të Komisionit të Prokurimit Publik duke përmendur vendimin nr. 615/2014 datë 27.11.2014 etj.*

*Referuar VKM 354 datë 11/05/2016, neu 2 parashikon [...].*

*Seksioni II “Strukturat në Ambientet e Jashtme” neni 30 “Parimet e tarifave”:* “1. Përveç kostove të instalimeve në natyrë, kostot e llogaritshme, për shërbimet themelore për strukturat në ambientet e jashtme, në mënyrë specifike përfshijnë kostot për strukturat dhe projektet e mëposhtme, ku ofruesi i shërbimit merr përsipër planifikimin e tyre teknik dhe / ose mbikëqyr realizimin e tyre: i) rrjedhave ujore të vetme me elemente të konsiderueshme ekologjike dhe të peizazhit; ii) pellgjeve ujëmbledhëse; iii) punime tokësore në shkallë të gjerë si pjesë e projektimit të peizazhit; iv) prejrrje të thjeshta dhe përforcime si një mjet për projektimin e peizazhit nëse kërkohet mbikëqyrje e përcaktuar në Kreun IV; v) barriera zhurma izoluese si një mjet për projektimin e peizazhit; vi) strukturat për mbajtjen e ngarkesave dhe për përforcimin e tokës, mbështetjet pa ngarkesën e trafikut, si një mjet për projektimin e peizazhit nëse nuk kërkon shërbime të përcaktuara në Kreun IV; vii) rrugë – kalimet dhe urat nëse nuk kërkon shërbimet e përcaktuara në Kreun IV; viii) rrugët e papërshtatshme për trafikun e rregullt të makinave me objekte të thjeshta të kullimit plus rrugët e tjera dhe sipërfaqet e shtruara të planifikuara si karakteristika të projektimit të strukturat në ambient të jashtëm të cilat nuk kërkojnë shërbime të përcaktuara në Kreun III”.

*Në vijim nuk përfshihen në kostot e llogaritshme strukturat në ambientet e jashtme: i) ndërtesa dhe shpenzimet e listuara në nenin 23, pika 3; ii) punë për themelet dhe sipërfaqet e përfunduara të zonave të këmbësorëve duke përjashtuar kostot e shtrimit të sipërfaqes.*

*Seksioni III “Vepra inxhinierike” neni 34 “Fusha e veprimit” veprat inxhinierike përfshijnë: 1. Strukturat dhe objektet për furnizim me ujë; 2. Strukturat dhe objektet për largimin e ujërave të ndotura; 3. Strukturat dhe objektet për inxhinieri hidraulike, përveç objekteve të hapura të përcaktuara në nenin 2, pika 11; 4. Strukturat dhe objektet për furnizimin dhe largimin e gazrave dhe trupat e ngurtë duke përfshirë ndotësit e ujit, lëngje me përjashtim të objekteve të përcaktuara në nenin 52; 5. Strukturat dhe objektet për depozitimin e mbeturinave; 6. Objekte inxhinierike për shërbime transporti dhe qarkullim; 7. Projekte të tjera individuale me përjashtim të ndërtesave dhe antenave të transmetimit.*

*Seksioni IV “Struktura e transportit dhe qarkullimit” neni 40 fusha e veprimit, strukturat e transportit përfshijnë: “1. Strukturat e trafikut rrugor dhe sinjalistikës me përjashtim të rrugëve të bicikletave, shtigjeve apo hapësirave të jashtme siç përcaktohet në nenin , pika 11.2. Strukturat e trafikut hekurudhor. 3. Strukturat e trafikut ajror.*

III.1.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme, pasi operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. në përputhje me pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme në vlerën që i përket sipas kësaj përqindje. Ashtu siç edhe vetë operatori ekonomik ankimues pretendon, ky i fundit për të vërtetuar se ka kryer eksperiencën të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ka paraqitur disa kontrata (9 të tilla), ku rezulton se:

i)

- kontrata datë 28.08.2015 lidhur mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt “Rikonstruksion fasadash, çatish, riveshje të mureve në qendër”, me afat 6 muaj, me vlerë 46.886.617 lekë pa tvsh, datë fillimi kontratës 28.08.2015 dhe datë mbarimi 26.05.2016;

- kontrata datë 27.04.2015 lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. (50%) & “Xhengo” sh.p.k. (33%) & “Vashtemia” sh.p.k. (17%) dhe Bashkisë Korçë, me objekt

”Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku, sheshi i poliklinikës, sheshi i xhamisë, sheshi i pazarit, rruga e Mborjes, rruga e Ravonikut”, me afat 12 muaj, me vlerë 282.606.454 lekë, me datë fillimi 27.04.2015 dhe datë mbarimi 05.04.2016;

janë kontrata të cilat rezultojnë jashtë afatit 3 vjeçar të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, e si të tilla këto kontrata nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, për kontratën me objekt ”Rikonstruksion fasadash, çatish, riveshje të mureve në qendër”, rezulton se, ka mangësi në dokumentacion, pasi nuk është paraqitur as dokumenti çertifikatë e marrjes në dorëzim, sipas përcaktimit të kriterit në dokumentat e tenderit si më sipër cituar.

ii)

- kontrata datë 18.04.2017 lidhur mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe operatorit ekonomik ”Curri” sh.p.k. me objekt ”Ndërtim asfaltim i rrugës Cërrik – Belsh – Dragot – Kuçovë – Urë Vajguore – (Segmenti Degëzim Grekan – Dragot), me afat 8 muaj, me vlerë 318.219.526 lekë pa tvsh; të cilës i referohet edhe operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kushtit të përcaktuar në pikën 2.3.1./a e Shtojcës 12 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se, bashkëlidhur është paraqitur edhe dokumentacioni: Formular vlerësimi për operatorin ekonomik ”Curri” sh.p.k. (100%), me vlerësimin: mirë - përmbushur; Formulari i ofertës së kësaj kontrate; Akt kolaudimi, procesverbal kolaudimi; Situacion përfundimtar për periudhën 29.05.2017-28.09.2017; Çertifikatë e përfundimit të punimeve; Fatura tatimore shitje, të panënshkruara nga blerësi. Konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kontratë, pasi ka mangësi në dokumentacion dhe nuk e ka paraqitur atë sipas kriterëve të përcaktuara nga dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, referuar preventivit të punimeve të kësaj kontrate, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues ka kryer punime të tilla si punime dherash dhe prishjet (rrafshim skarpate në gërmim, f.v. dheu humus, mbjellje bari në skarpate), punime shtresa (shtresë zhavorr lumi, shtresë çakëll, shtresë stabilizant, shtresë binderi me granil, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil), vepra të vogla arti (gërmim e transport dheu, mbushje me zhavorr pas mureve mbajtës, struktura monolite betoni, shtresë zhavorr lumi, hidroizolim me emulsion, furnizim vendosje tuba plastmasi, f.v. hekur betoni, tombino me tuba betoni, gabiona me rrjetë teli të zinguar), punime sinjalistike dhe zëra shtesë (guardrail, fundore guardrail, f.v. tabela të ndryshme rrugore, panel ploësues i sinjalistikës trekëndor, tabelë drejtëkëndore, përvijues modularë të theksuar, bojë termoplastike, vijëzim shirita gjatësor dhe anësor, f.v. reflektor në muret pritës, spostim linje telefonie, spostim linje elektrike).

- kontrata datë 10.06.2016 lidhur mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe operatorit ekonomik ”Curri” sh.p.k. me objekt ”Sistemim – asfaltim i rrugës së unazës ”poliklinikë – 7 pallatet” Vlorë”, me afat 12 muaj, me vlerë 346.777.116 lekë pa tvsh; të cilës i referohet edhe operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kushtit të përcaktuar në pikën 2.3.1./a e Shtojcës 12 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se, bashkëlidhur është paraqitur edhe dokumentacioni: Formular vlerësimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë ”Curri” sh.p.k. (85%) & ”Be - IS” sh.p.k. (15 %), me vlerësimin: Punimet janë kryer në kohë dhe me cilësi- e përmbushur; Situacion financiar përfundimtar për periudhën prill – korrik 2017; Akt kolaudimi;

Fatura tatimore, të panënshkruara nga blerësi; Çertifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të nënprojektit.

Referuar preventivit të punimeve të kësaj kontrate, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues, nuk ka paraqitur asnjë dokument për të verifikuar pjesën e përqindjes apo zërat konkretë që ai ka marrë përsipër për të kryer në këtë kontratë me qëllim verifikimin e saktë të tyre. Nga ana tjetër edhe nëse do t'i referohemi preventivit në total të kontratës së paraqitur, konstatohet se ankimuesi ka kryer punime të tilla si punime ndërtimi (punime prishje, punime gërmimi zbankimi dhe ndërtim shtresash rrugore auto, punime gërmimi zbankimi dhe ndërtim trotuar këmbësorësh me kufizime nga ngjëlberimi, punime kanalizime KUB, punime riparim ujësjellësi, punime riparim ujësjellësi, punime kanalizime KUZ), punime sinjalistikë rrugore (f.v tabela trekëndore, tabela të ndryshme rrugore, vijëzim shirita, bojë bikoponente), punime ndriçimi rrugor (f.v. shtylla metalike për ndriçim, f.v. morsetë tokëzimi shtylle, f.v. krah dy degësh për shtylla metalike), punime gjelbërimi dhe dekorimi (dru dekorativ, bar i kultivuar, shkurre dekorative, shkallë dhe stola dekorativ), punime për vepra arti (punimet për ndërtimin e kalimit, punimet për ndërtimin e kalimit tek kryqëzimi tek kaminat, punimet e kanalit të hapur – gërmim dheu, pastrim kanali, f.v. çakëll, f.v. mbushje me çakëll, f.v. beton nivelues, f.v. hekur për muret dhe dyshtemenë e kanalit, f.v. zgarë metalike).

III.1.7.1. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dy kontratave të mësipërme të cituara në pikën (ii), të pikës III.17., të cilat operatori ekonomik ankimues i pretendon se secila prej tyre duke u marrë në konsideratë veç e veç e plotësojnë kushtin e përcaktuar në pikën 2.3.1/a, ku përcaktohet se: *Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim*, gjykon se, nuk janë kontrata të ngjashme, pasi referuar preventivit të kësaj procedure si edhe specifikimeve teknike, janë përcaktuar zëra specifikë që përfshijnë punime specifike sic janë edhe gërmimet në shkëmb, punimet në det, kanale dhe hendeqe, argjinaturat dhe mbushjet, digat, themelet etj., apo zërat e preventivit ndërmjet të cilave përmendim të tilla si: Prishje struktura betonarmeje + transport, Prishje mur guri, Çmontim parmak çeliku + transport, Prishje trotuari me beton dekorativ të derdhur + transport, Heqje shtyllash ndriçimi + dorëzim në bashki 12m të larta, Çmontim dyshteme dërrase + transport, Heqje dhe depozitim në kantier i gurëve të medhenj, Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet, Gërmim dheu në seksion të lirë me krahë, në tokë të butë, kateg. I-II, trans. K d deri 10m, Transport materiale të ndryshme deri 10 km, Heqje pemësh dhe dorëzim në bashki, Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri, Shtresë stabilizant t=20cm, Nenshtrese Beton C12/15, Beton C30/37 - Bazament për muret, Beton C25/30- Muret mbajtes, Beton C25/30 - Shkallet në det, Beton I bardhe C30/37 - shkalla e parapetet, Beton I bardhe C25/30 – Kollonat, Beton I bardhe C25/30 - Traret në +6.308, Shtrese betoni C20/25 mbi dhomen teknike të pishines, Beton C25/30 - Soleta 10 cm me beton të furçuar, Beton C20/25 - Beton me pigment të zi për murin ballor dhe stolin, Beton C30/37 -për soleta të plota, Beton C20/25 - Beton me pigment të zi për Klaustrat, Beton C30/37 me pigment të zi – Kollona, Beton C25/30 - Soleta b/a 18 cm & traret rigjides perimetrale, Beton C25/30 - Traret e themelit, Çelik armimi B500b φ 6-10mm ton, Çelik armimi B500b > φ 10mm ton, F V bordura betoni 25x35 cm,

Beton C30/37- Muret mbajtes, Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka, Ndërtim trotuari me beton dekorativ që në sipërfaqe ka pllaka zalli deri në 10cm diameter, Ndërtim shtrese betoni arkitektonik me finiturë çimento e kuarc i furçuar  $t=18\text{cm}$  m<sup>2</sup>, Ndërtim shtrese betoni për rampë me finiturë çimento + kuarc, kuriz peshku, Ndërtim shtrese me beton dekorativ brenda rampës, Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri, Shtrese binderi me granil gur kave, 10cm, me mak. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama, Shtresë mbrojtëse e hidroizolimit, F.V.Parmak metalik inoksi në hapësira e shkallë, F.V.Rërë për plazhin - 20cm, F.V.zhavor për plazhin -30cm, F.V Shkëmbinjsh, Zgarë tërthore për mbledhje uji çelik i galvanizuar, Granil I zi traktolit I Lezhës 8 cm, Ndërtim bordurë betoni  $t=15\text{cm}$  me lamë 50mm të fiksuar sipër, Veshje me kurasanit të zi për finituren e pishinave, Bazament dushesh me beton, Ulluk me zgarë për dushet, Ulluk me zgarë për pishinën, Dyer metalike galvanizuar e lyer e zezë në kabina ndërrimi e tualete, Dyer me dy kanata për depot, Derë kryesore me rrëshkitje për ambientet e tualeteve, Arkitra betoni i lyer i zi sipër dyerve, Mur me tulla të plota zak, deri 12m, Ilaç përzier M 25 për banjot e dhomat e zhveshje, DysHEME me beton industrial (çimento +kuarc) për banjat e dhomat e zhveshjes, Boje ngjyrë e bardhë e çelët për sinjalistikë rrugore, Boje ngjyrë gri e çelët për sinjalistikë rrugore, Mur mbajtës i përkohshëm, Acer opalus multi-stem -  $h>7\text{m}$  - perimetër 40, Acer opalus standard tree -  $h>8\text{m}$  - perimetër 45, Cercis siliquastrum multi-stem -  $h>6\text{m}$  - perimetër>35, Cercis siliquastrum standard tree -  $h>8\text{m}$  - perimetër>40, Prunus cocomilia -  $h>7\text{m}$  - perimetër>40, Pinus halepensis - N - perimetër 50/60, Pinus pinea - N - perimetër 50/60, Syagrus romanzoffiana, Eödyetia bifurcata, Eashingtonia robusta, Monstera deliciosa, Phoenix roebelenii, Phormium tenax, Rhapsis excelsa, Clivia miniata, Yuça filamentosa, Festuca glauca ‘elijah blue’ [...] Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, Mbulim tubi me rere, Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III, [...] Transport materiali i germuar, Shtrese zhavorri  $t=10\text{ cm}$  nen beton per pusetat (per 2 cope), Shtrese betoni  $t = 10\text{ cm}$  klasa C 7/10 ( per 2 cope....., F.V. Shkalle metalike te zinguara ( per 2 cope), F.V. Reduksion PE OD 25/20 PN 10, F.v Tube prej Polietileni PE-HD SDR 17,6 sipas DIN 8074, DN 300, D315, F.v Tub si me siper por DN 250, d 280 [...], F.v Rekorderi (brryla, Ti, Fllanxa, Reduktione) prej Polietileni PE-HD SDR 17,6 sipas DIN 8074, DN 300, F.v Rekorderi (brryla, Ti, Fllanxa, Reduktione) prej Polietileni PE-HD SDR 17,6 sipas DIN 8074, DN 250, d 280, F.v Rakorderi si me siper por DN 200, d 225...., Germim dheu me eskavator kat.III, Mbulim tubi me rere ( nen tub dhe mbi tubo [...], Shtrese betoni C 16/20 per kuneten e rruges  $t = 15\text{ cm}$ , Pusete b/a shiu 40 x 60,  $h = 100\text{ cm}$ , me kapak giz 0 2.130/1 Mure b/a  $t = 21\text{-}30\text{cm}$ ,  $h \sim 4\text{m}$  C 20/25, Veshje skarpatesh 10 cm zhavorr + 20 cm gure[...], F.V Reduktues presioni  $\text{Ø } 2'' = 63\text{ mm}$ , F.V Mates uji dn50, F.v Pusete b/a kontrolli per lidhjet e furnizimit me uje 100x100 H=150cm, F V Kapak gize  $\text{Ø}600$ , D 400 me gomine, F V ëaterstop, F.v Tubacion dhe rakorderi polipropileni me gomina DN- $\text{Ø}50$ , F.V pilete dysHEMEJE  $\text{Ø } 50\text{ mm}$ , F.V dush per hapësira publike, me dim 19x17x215 Rubinet dushi+koka, antivandal me kohemates me shtypje, F V ëaterstop [...], Percjelles 1x16 mm<sup>2</sup> V-J per tokezim, Percjelles Cu i zhveshur 1x25 mm<sup>2</sup> per tokezim horizontal, Percjelles Cu i zhveshur 1x50 mm<sup>2</sup> per tokezim horizontal, Elektrode tokezimi 1.5m Cu kompletuar me morsete, Puseta (Manhole) per impiantin elektrik 30x30cm me kapak dekorativ sipas veshjes se sheshit ku do te perdoren (same texture as floor, Puseta betoni per impiantin elektrik 90x90cm [...], Kasete vetrorezine IP 56 , rezistente ndaj korrozionit me perdorim ne ambjente me perqendrim te larte te kripes, per vendosjen e , Tub i ngurte jo zjarr percues per instalim jashte murit D20 I kompletuar me aksesore, Tub fleksibe jo zjarr percues per instalim jashte murit (guajne) D20 I kompletuar me

aksesore..., Germim kanali ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m<sup>2</sup>, F.V Kabell unipolar alumini 24kV me izolim XLPE per lidhjen e kabines me rrjetin unazor e tensionit te mesem 20kV . 3x1x185mm<sup>2</sup>. Eshte parashikur shtrirja e kabllit ne TM deri prane rruges kryesore ku duhet te sigurohet lidhja nga OSHEE, F.V Kabell unipolar bakri me izolim dhe veshje EPR 3x2x150+1x150+1x150mm<sup>2</sup> FG16R16 per furnizimin e kuadrit kryesor, F.V Kabell bakri me izolim dhe veshje EPR 3x1,5mm<sup>2</sup> FG16OR16, F.V Kuti shperndarese IP67 se bashku me materialin izolues(xhel bikomponent ) per mbushje per te mundesuar perdorimin e kutive ne puseta, F.V PANELI KRYESOR ne dhomen teknike i realizuar ne kasete metalike rezistente ndaj korrozionit per ambjente me perqendrim te larte kripe ,ne perputhje me skemen elektrike, I kompletuar me mbrojtje magneto-termiko-diferenciale dhe rikycje automatike, mates energjije te kolauduar dhe te aprovuar nga OSHEE, F.V. Cele hyrje/dalje 24kV/20kA SF6, F.V. Cele Trafo Cele Mbrojte-Automat 24kV/20kA SF6-DM1-A, F.V. Kit terminale kablllo 20kV raycheme indoor, F.V. Transformator me ftohje me vaj Sn=400kVA, 20/0.4kV, u=6%, Ddyn-11 me rezistenti ndaj korrozionit per perdorim ne ambejnte me perqendrim te larte kriprave...., F.V. Rrjete metalike e zinkuar per rrethimin e transformatoreve H2200mm, F.V. Zbarre ekuipotenciale Bakrri e kompletuar me distancator dhe bulloneri, 2 x dalje FG16R16 150mm<sup>2</sup> +10x dalje, F.V Ndricues dekorativ Tip. 1 20.5 Ë,1226Lumen , kendi i perhapjes se ndricimit 15° , 4000K , Stainless steel · Cast stainless steel per instalim ne toke, Ø 210 · 255 · 330 mm, me shkalle mbrojtje IP68 10m , ngarkesa max. ne shtypje 5000kg, reflektro prej alumini puro, garancia e modulit te ndricimit LED 20 vite[...] Demontim dhe rimontim i shtyllave ekzistuese te ndricimit rrugor, F.V Pompe vertikale per pishina me parafilter e Tipit UNIBAD per UJE DETI me keto karakteristika: - Prurje 70 m<sup>3</sup>/ore - Lartesi hedhje 12 mku - 400V, 50HZ 5 KË, F.v Armatura per pishina te Øpit Z011-AS, DN 80 me komandim manual, F.v Armatura si me siper por DN 50, F.v Armatura prej PVC (Kugelhahn) per Pishina te dimensioneve te ndryshme d 20 deri d, F.v Sistemi i futjes se ujit ne pishine nepermjet tubacioneve prej PVC-je e dimensionuar duke marre parasysh parimin e futjes ne menyre uniforme te ujit ne pishine me dimensione te ndryshme DN 100- DN 40 cope 1, F.v Diza prej PVC-je ngjyre e bardhe qe sherbejne per shperndarjen uniforme te ujit ne pishine me kapacitet 3,55 -13 m<sup>3</sup>/ore, 2", F.v Filter me rere kuarcore prej GFK (vetrorezina) ne perputhje me DIN 19605/19643 me keto karakteristike teknike:[...], F.v Rërë kuarcore (Sand) me kokrrize 0,71-1,25 mm. per mbushjen e filtrit ne lartesi 1000 mm....., F.v Pompe vertikale per pishina me parafilter e Tipit UNIBAD per UJE DETI me keto karakteristika, F.v Kompresor ajri (spülluftgebläse) per pastrimin e filtrit me ajer me keto karakteristika teknike: F.v Armatura per pishina te tipit Z011-AS, DN 315 me komandim manual....., F.v Aparati i matjes se parametrave klorit, pH, Redoksit, klorit te lidhur si edhe temperatures ne menyre te vazhdueshme si edhe kompesimin dhe dozimin sipas nevojës i tipit DEPOLOX-E700 P, F.v Pompe dozimi per dozimin e chlorit te lengshem ma keto karakteristika, F.v Paneli elektrik per komandimin dhe mbrojtjen e pompave sipas normave VDI, rregullimim automatik te nivelit te ujit ne rezervuar, komandimin e sistemit te matjes dhe dozimit te kimikateve sipas normave VDI, me rele kohe dhe termike. Mbrojtja dhe komandimi i sistemit te ndricimit. Llampat e ndricimit per gjendje pune qetesi dhe avari, Instalimi i kablllove elektrike te dimensioneve te ndryshme, F.v Furnizimi, punimi dhe montimi i shkalleve te cilat sherbejn per daljen nga pishina prej material "Inox" me pese shkelese, shkalle (shkalla e pare duhet te kete gjeresi me te madhe sa kater shkallet tera) dhe gjeresi 500 nga akest e mbajteseve) Mbajtesja anesor ku shtangohen shkallet dhe te cilet sherbejn njekohesisht per dalje nga pishina duhet te jene po ashtu nga "inox-I" I poliruar Ø43mm. Ne cmim te llogariten te

gjithë akesorët e nevojshëm për këtë pozicion, F.V Furnizimi, punimi dhe montim me kapse litaresh nga "inoxi" për Lane rope. Prodhues Astralpool tipi: INOX AISI 316 ose prodhues tjerë me cilësi dhe karakteristika të njëjta. Blerje, transport dhe montim, F.v Paneli elektrik për komandimin dhe mbrojtjen e pompave sipas normave VDI, rregullim automatik të nivelit të ujit në rezervuar, komandimin e sistemit të matjes dhe dozimit të kimikateve sipas normave VDI, me rele kohe dhe termike. Mbrojtja dhe komandimi i sistemit të ndricimit. Llambat e ndricimit për gjendje pune qetesi dhe avari, zëra këto, disa prej të cilave nuk rezultojnë të reflektuar në kontratat e mësipërme të pretenduara nga ankimuesi si të ngjashme dhe në përputhje me përqindjen e caktuar në kontratën e bashkëpunimit. Pra nga verifikimi i këtyre dy kontratave (duke u trajtuar secila veç e veç) në përmbushje të kriterit për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, rezulton se zërat e preventivit të kryera në këto kontrata nuk janë të ngjashme me këto zëra të përcaktuara në preventivin e publikuar për këtë procedurë prokurimi, e për më tepër që rezulton që një numër i konsiderueshëm i zërave të preventivit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, nuk gjejnë pasqyrim në këto kontrata të ngjashme të paraqitura nga ankimuesi.

III.1.7.2. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit që *Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik*, preventivit të autoritetit kontraktor, zërave kompleksë e specifikë të kësaj procedure prokurim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Sipas preventivit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për këtë procedurë prokurimi rezulton se, një numër i konsiderueshëm i zërave të punimeve, që në raport me ofertën e tij ekonomike në total zënë një përqindje të konsiderueshme të punimeve, referuar kontratave të ngjashme (dy të mësipërmet secilat veç e veç) të paraqitura, nuk rezulton të jenë kryer zëra të tillë punimesh, qoftë edhe në një vlerë minimale për të vërtetuar se ky operator ekonomik është i aftë dhe ka kapacitetet e duhura për të kryer punimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dy kontratat e mësipërme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.1./a.

iii)

- Kontrata nr.4269/8 datë 09.10.2017 lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "SMO Union" sh.p.k. shpk dhe KESH sh.a., me objekt "Rikonstrukcion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman", me afat 12 muaj, me vlerë 266.142.909 lekë pa tvsh, është e shoqëruar me faturë tatimore një një vlerë 11.284.630 lekë pa tvsh dhe nuk ka bashkëlidhur fatura të tjera tatimore për të gjithë vlerën e kontratës, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në dokumentat e tenderit ku kërkohet që duhet të paraqiten fatura tatimore për çdo situacion punimesh. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur asnjë dokument për të verifikuar pjesën e përqindjes apo zërat konkretë që ai ka marrë përsipër për të kryer në këtë kontratë me qëllim verifikimin e saktë të tyre.



- Kontrata nr.62/6 datë 10.03.2013 lidhur midis shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe Bashkisë Tiranë, me objekt ”Rikualifikim urban i zonës që kufizohet me rrugën e ”Durrësit”, ”Teodor Keko”, Lumi Lana, Rruga ”Anesti Lubonja” si dhe parku tek ish pista e Aviacionit, njësia bashkiake nr. 7”, me afat 8 muaj, me vlerë 96.139.323 lekë me tvsh, rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e marrjes në dorëzim për kontratën e paraqitur si të ngjashme, kriter i përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës 12 të dokumentave të tenderit.

- Kontrata nr.5693/5 datë 14.02.2019 lidhur midis shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe Bashkisë Vorë, me objekt ”Rikonstruksion i rrugës industriale pranë Terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë”, me afat 90 ditë kalendarike, me vlerë 34.613.372 lekë me tvsh, rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve, kriter ky i përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës 12 të dokumentave të tenderit.

- Kontrata nr.3985/5, datë 13.09.2018 lidhur midis shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe KESH Sh.a., me objekt ”Rehabilitim i digës së Gjocaj në HEC Vau i Dejës”, me afat 6 muaj, me vlerë 23.852.492 lekë me tvsh, nuk rezulton të ketë paraqitur fatura tatimore shitje dhe formular vlerësimi, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.1 të shtojcës 12 të dokumentave të tenderit.

- Kontrata datë 08.06.2015 lidhur midis shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt ”Ndërtim i urës së Lushës mbi lumin Drin i Zi, Komuna Arras”, me afat deri më 30.09.2016, me vlerë 59.708.135 lekë pa tvsh, ku rezulton se është paraqitur fatura tatimore me vlerë 59.706.578 lekë pa tvsh.

III.1.7.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për plotësimin e kushtit të dytë të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe konkretisht në pikën 2.3.1./b, ku përcaktohet *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, referuar kontratave të listuara më sipër, të paraqitura këto nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike, duke marrë në konsideratë vetëm ato kontrata që janë brenda afatit (pra duke përjashtuar dy kontratat e sipërcituara, të arsyetuara që nuk do të merren në shqyrtim, pasi janë jashtë afatit tre vjeçar të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor), si edhe vetëm ato kontrata të cilat janë me dokumentacion të saktë e të plotë (duke përjashtuar ato kontrata që kanë mangësi në dokumentacion si më sipër sqaruar), pa i hyrë thelbit e shqyrtimit të tyre për ngjashmërinë me kontratën objekt shqyrtimi (të cilat nuk rezultojnë të jenë të ngjashme me këtë procedurë si nga specifikimet teknike, nga kompleksiteti, metodologjia, teknologjia, zërat e punëve që do të bëhen etj) pra thjesht duke i konsideruar si shifra apo vlera (siç pretendon ankimuesi që ka paraqitur 9 kontrata) rezulton nga përlllogaritjet e kryera se kushti i dytë në vlerën sa dyfishi i fondit limit, duke llogaritur të gjitha kontratat përveç atyre që janë përjashtuar si më sipër arsyetuar (pra ato kontratat të cilat kanë mungesa nga ana e tyre në dokumentacion dhe janë jashtë afatit), edhe në rastin hipotetik nëse do të konsideroheshin të ngjashme (pa i hyrë shqyrtimit të tyre dhe zërave të punimeve), sërish operatori ekonomik ankimues nuk arrin të provojë se nga ana e tij plotësohet kushti i dytë i kërkuar në DST për paraqitjen e disa kontratave të ngjashme në një vlerë sa dyfishi i fondit limit të procedurës së prokurimit, në përputhje me përqindjen e tij të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

III.1.8. Sa më sipër, referuar kontratave të marra në konsideratë si më lart analizuar, për plotësimin e të dy kushteve veç e veç, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, sërish operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. nuk arrin të përmbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën që i korrespondon sipas përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Rrjedhimisht, referuar përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Xhengo" sh.p.k., bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi nuk plotëson vlerën për kontrata të ngjashme.

Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.9. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi"*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi..."*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *"Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje"*.

III.1.10. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*.

III.1.11. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Xhengo" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat

e tenderit, pasi operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për kontratat e ngjashme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i konform kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Xhengo” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesin e ankimesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për operatorin ekonomik të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislati janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për më tepër, që operatori ekonomik ankimes, nuk ka ngritur pretendime për operatorët ekonomikë të kualifikuar në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimit të përcaktuar në nenin 63 të ligjit për prokurimin publik.

Për rrjedhojë, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimes nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimes nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Xhengo” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33285-08-09-2019, me objekt: “*Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti Jugor nga Fushat e Sportit deri tek Tuneli*”, me fond limit 458.286.818,65 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1615 Protokolli**

**Datë 11.10.2019**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**